

INTERNETI – SFIDË E SHOQËRISË BASHKËKOHORE

Hyrje

Çdo etapë ka karakteristikat e saj dalluese, të cilat në mënyrë të pashmangshme lënë gjurmë në jetën e njerëzve të asaj kohe.

Sot jetojmë në kohën e progresit dhe zhvillimit të madh, në kohën e kulmimit të teknologjisë dhe arritjeve të saj. Çdo kohë ka rrjedhën e saj, “koritën e saj” në të cilën rrjedh si uji i burimit. Nuk kemi asgjë kundër kësaj kohe të teknologjisë, mirëpo, ajo ka shumëçka të drejtuar kundër nesh. Kjo epokë ka anën e saj pozitive, megjithatë, ajo fsheh edhe anën tjetër, e cila është e vështirë ose e pamundur të kuptohet. Kjo epokë e teknologjisë i ngjan një pasqyre. Ne e shohim veten në pasqyrë ashtu si na paraqet ajo, por, e njëjta, ajo pasqyrë, e fsheh dhe nuk e tregon anën e kundërt – që paraqet realitetin tonë të njëjtë.

Në kohën në të cilën jetojmë, dëshirojmë të arrijmë gjithçka, sikurse thotë populli “të gatshme”, e gjitha e shërbyer “si në pjatë.”

Rrjeti botëror i të dhënave – interneti, shënjoj në masë të madhe kohën tonë. Sipas të dhënave statistikore, internetin e përdorin më se 3.8 miliardë njerëz dhe se ky numër, nga dita në ditë, vazhdimisht është në rritje. Ky rrjet i ofron njerëzimit shërbime të mëdha, por në të njëjtën kohë në prapavijën e vet fsheh edhe shumë rreziqe.

Prapavija e internetit

Termi “Internet” me shkronjë të madhe në fillim, është shkurtësë e dy fjalëve angleze: *Interconnected* dhe *network*, që do të thotë “rrjeti i ndërlidhur”, kurse në përgjithësi, interneti, me

* Autori i tekstit është student në programin e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, në lëmin e *Tefsirit* (komentimit të Kuranit).

shkronjën e vogël “i” tregon qasje në rrjetin dhe shërbimet e tij, të tilla si: *World Wide Web*⁽¹⁾ (www) dhe postën elektronike.

Përmes përdorimit të internetit ne i përcjellim ndodhitë në tërë botën, njihemi me kultura dhe zakone të largëta e të huaja; mund të përcillen kërkimet shkencore dhe arritjet; mund të konsultohen ekspertë nga fusha të ndryshme; të realizohen shërbimet bankare etj.

Këto janë vetëm disa nga shërbimet e shumta që i ofron interneti, dhe të gjithë ne çdo ditë, pak a shumë i përdorim. Mirëpo, siç përmendëm më sipër, ekziston edhe ana tjetër e medaljes, sepse ky rrjet bart edhe shumë rreziqe dhe aspekte negative: interneti është një mjet ideal për përhapjen dhe promovimin e ideve të gabuara të të gjitha ngjyrave dhe llojeve. Nëpërmjet këtij rrjeti futen dyshime në fe, me promovimin e ideologjive sektare të devijuara, publikisht dhe haptazi ftohet në imoralitet dhe në shumë devijime, të cilat janë në kundërshtim me fenë, moralin dhe natyrën e shëndoshë njerëzore. E gjitha kjo plasohet në një mënyrë perfide, që magjeps, josh dhe helmon fëmijët, adoleshentët, madje edhe të rriturit, shkatërron dëlirësinë, çon në rrugë djallëzore dhe inkurajon një shumëllojshmëri të sëmundjeve dhe perversiteteve. Interneti përdoret për qëllime të abuzimit seksual, kërcënime dhe shantazhe, sidomos në mesin e të rinjve dhe adoleshentëve.

Interneti dhe rrjetet sociale mundësojnë përhapjen e thashethemeve dhe trillimeve, si dhe cenohet privatësia dhe intimitja përmes spiunimit dhe hakimit. Po ashtu, varësia nga internetishkakton sëmundje mendore dhe fizike, si dhe rezulton të jetë shpesh përgjegjëse edhe për neglizhencën e jetës reale dhe problemeve në familje e shoqëri.

Me të gjitha dobitë që ofron interneti dhe rreziqet që sjell, është e qartë se ai është testi i imanit dhe moralit të njeriut. Portat

¹ Ang. web do të thotë “rrjeti i merimangës”, sepse rrjeti botëror është i thurur si rrjeti i merimangës dhe përhapet kudo – world wide – dhe kështu shkurtesa nga adresa WWW – World Wide Web. Shërbimin WWW e shpiku britaniku Tim Berners – Lee në vitin 1989 në CERN të Zvicrës. Është shërbimi më i popullarizuar dhe më i madh në të cilin janë vendosur faqet e internetit, të cilat mund të shihen nga kushdo, përveç nëse ato janë të mbrojtura me fjalëkalime ose për disa arsye janë të bllokuara. Shih: Silvana Burilović dhe Željko Tanjić, “Kršćanstvo i internet – izazov za teologiju”, Universiteti në Split, Zagreb, 2012, f. 89.

e së mirës dhe së keqes janë të hapura gjerë. Për shkak të këtij realiteti, njeriu që kujdeset për fenë e tij, duhet të ndalet para këtij fenomeni dhe do të shqyrtojë veprimet e veta.⁽²⁾

Njerëzit besimtarë, të cilët kanë përgjegjësinë ta shohin jetën me syzet e islamit, janë të detyruar ta përdorin këtë teknologji brenda standardeve të besimit të tyre. Kështu duhet t'i konsiderojë një besimtar të gjitha mirësitë e Allahut. Çdo mirësi është një shkak falënderimi ndaj Allahut, nëse ato përdoren për mirë. Ndërsa, kur mirësia del përtej standardit të saj, bëhet shkak i humbjes së njeriut. Pasuria që kemi, pjesëtarët e familjes dhe të gjitha mirësitë e tjera përfshihen brenda këtij rregulli.⁽³⁾

Humbja e kohës dhe interneti

Një prej rreziqeve dhe aspekteve negative të internetit është se ai është shkaktari kryesor i humbjes së kohës dhe neglizhencës së disa obligimeve fetare, të tilla si namazi etj. Zoti xh.sh., u betua në kohën se njeriu është i humbur dhe i dëshpëruar, kushdo qoftë ai, përveç atij që kohën e vet e shfrytëzon për gjëra të mira e të dobishme. Qëmoti është thënë nëse nuk e shfrytëzojmë kohën, atëherë ajo do të na shfrytëzojë ne, ose "do të na shtrydhë", siç e përkthen konceptin "asr" gjatë komentimit të sures el-Asr përkthyesi i Kuranit në gjuhën boshnjake, akademiku Enes Kariq.⁽⁴⁾

Koha është ajo që uli popujt, të cilët dukeshin se ishin të lartë dhe ngriti lart popuj të tjerë që dukeshin se ishin të ulët. Koha na tregon se e bëri krenar të drejtin dhe e poshtëroi të padrejtin e zullumqarin. Koha na mësoi që, kur një popull kaloi në padrejtësi, u dha pas dëshirave epshore, pas interesit personal duke e lënë

² Hakija Kanurić, „Internet-Savremeni test imana“, **Asr** (Islamski informativni časopis), nr. 79. ... Nga ueb-faqja: <http://el-asr.com/tekstovi/internet-savremeni-test-imana/>. qasja në internet, me datën: 01.03.2018.

³ **Nureddin Jëlldëz**, „Pa internet mund të qëndrojmë, por pa kufij jo!“, **Etika**, Nr. 115 – Tetor 2017, Tiranë, f. 8.

⁴ Akademik Enes Karić, „Vrijeme u Kur'anu“, **Takvim** (Kalendar) për vitin 2015, Rijaseti i Bashkësisë Islame në Bosnje e Hercegovinë, Sarajevë, 2014, f. 65. Ose shih: Akademik Enes Kariq, „Koha në Kur'an“, **Edukata Islame**, përktheu: Azmir Jusufi, nr. 108/109 – 2015, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, Kosovë.

pas dore bashkësinë dhe interesin e përgjithshëm.⁽⁵⁾

Kështu koha është e pakthyeshme, siç thotë El-Me'arri: *"E djeshmja që shkoi – edhe pse është afër, të gjithë banorët e tokës nuk mund ta kthejnë atë!"*⁽⁶⁾

Çdo çast, i cili nuk shfrytëzohet në vepra të mira, është i humbur. Këto fjalë të lartësuara, jo vetëm që na tregojnëqartë, por na e tërheqin vëmendjen tonë në histori, si dëshmitare të veprave njerëzore.⁽⁷⁾

Në Perëndim thonë "koha është para", kurse në Lindje thonë që ajo është më e çmuar se paraja dhe thonë: "Koha nuk mund të blihet as me margaritar"⁽⁸⁾. Po, kjo është me të vërtetë kështu, megjithatë, koha është shumë më shumë se kaq.

Ah, sikur njerëzit të dinin rëndësinë e kohës! Aspak nuk është i habitshëm fakti që një njeri e kishte zotëruar një gjuhë të huaj vetëm duke mësuar gjatë pushimit në vendin e tij të punës, ose dikush tjetër, duke pritur porosinë e tij në restorant në një kohë prej 10-15 minutash. Mirëpo, sot secili që ulet në tavolinë duke pritur porosinë e vet në restorant, menjëherë pyet për fjalëkalimin e internetit, ose futet menjëherë në internet duke humbur kohën kot.

Nuk duhet të lejojmë që gjërat që sjellin dobi të na ikin nga dora, e të jemi prej atyre (Zoti na ruajtë) që do të thonë:

"Zoti ynë, tash pamë dhe dëgjuam, na kthe pra edhe një herë e të bëjmë vepra të mira, se tash jemi bindur"

(Es-Sexhde, 12)

Muhamedi s.a.v.s., në hadithet e tij na këshillon për shfrytëzimin e kohës, duke thënë:

"Shfrytëzoni pesë gjëra para pesë të tjerave: rininë para pleqërisë, jetën para vdekjes, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë dhe kohën e lirë para zënies së saj"

(El-Hakimi)

⁵ Sherif Ahmeti, *Komente dhe mendime islame*, Lidhja, Prishtinë, 1995, f. 174-175.

⁶ Akademik Enes Karić, „Vrijeme u Kur'anu“, ..., f. 72.

⁷ Muhamed Pandža dhe Džemaludin Čaušević, *Kur'an Časni – prevod i tumač*, Sarajevë, 1937, f. 947.

⁸ Asmir Halilović, *O začudnosti govora 2*, Bookline, Sarajevë, 2010, f. 132.

Po ashtu, transmetohet nga Muadh b. Xhebeli r.a., se Pejgamberi s.a.v.s., që ka thënë:

“Nuk do të lëvizë këmba e robit në Ditën e Gjykimit, derisa të pyetet për katër gjëra: Jetën – në çka e ka shpenzuar, rininë – se si e ka kaluar, paranë – se si e ka fituar dhe shpenzuar, diturinë – se si e ka përdorur”

(Et-Taberaniu)

Kontrollimi i informacioneve

Një nga veçoritë e internetit është se ai siguron një sasi jashtëzakonisht të madhe të informacioneve. Megjithatë, futja e këtyre informacioneve është në dispozicion absolutisht për të gjithë, në atë mënyrë që informacionet i postojnëjerëzit e të gjitha profileve, profesionistë e joprofesionistë, të diture injorantë, të virtytshëm e të pamoralshëm...

Kjogjë kërkon përzgjedhjen gjatë marrjes së informacioneve, të pranojmë dhe të konsiderojmë si të vërteta vetëm ato informacione që vijnë prej burimeve të njohura e të besueshme. Për këtë tregon qartë ajeti kuranor në të cilin Allahu i Lartësuar thotë:

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë...”

(El-Huxhurat, 6)

Allahu i plotfuqishëm urdhëron kontrollimin e lajmeve nga njeriu i pandërgjegjshëm dhe intrigues (*fasik*) nga kujdesi që të mos gjykohet sipas fjalëve të tij, sepse ky lajm mund të jetë një gënjeshtar dhe ai e transmeton gabimisht dhe si rrjedhojë edhe gjykimi mund të kryhet në bazë të fjalëve të tij. Është e njohur që Allahu ka ndaluar që të ndiqet rruga e mëkatarëve. Prandaj, shumica e ulemave refuzoi të pranojë transmetimin e lajmeve nga persona të panjohur, në mënyrë që të mos gabohet në ndonjë çështje të caktuar. Ka nga ata që pranojnë transmetimin nga persona të tillë, sepse sipas tyre është i detyrueshëm vetëm kontrollimi në rast se është përcjellës i lajmit vetëm mëkatarin, e jo personin i panjohur. Shumë përmendin se ky ajet është shpallur në lidhje me rastin e Velid ibn Ukbe ibn Ebi-Muajtit, kur Pejgamberi s.a.v.s., e dërgoi për të mbledhur zekatin nga fisi Benu-Mustalik.

Kjo ilustron nga një numër burimesh, por më i sakti është ai që përmend Imam Ahmedi në *Musnedin* e tij, nga i pari i fisit Beni Mustalik, Harith ibn Ebi-Dirari, babai i Duvejrijes binte l-Harith, nënës së besimtarëve r.a.⁽⁹⁾

Në Kuranin e madhërishtëm thuhet:

“...Thuaju: sillni argumentin tuaj (çka thoni) po qe se jeni të drejtë”.⁽¹⁰⁾

Edhe kur informacioni vjen nga burimi i besueshëm dhe konfirmohet vërtetësia e tij, për një gjykim të saktë për këtë është e nevojshme të dimë detajet dhe rrethanat që lidhen me të, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të plotë të ngjarjes në fjalë, për shkak se neglizhimi i rrethanave do të kontribuojë në keqkuptime. Si shembull, mund të na shërbejë rasti i jetës së Pejgamberit s.a.v.s., kur një natë e shoqëronte gruan e tij Safijën nga xhamia. Atë e panë dy sahabë, të cilët nxitonin duke u larguar nga ai, mirëpo, Pejgamberi s.a.v.s., i thirri dhe u tha:

“Ngadalë, ju të dy! Kjo është Safia (gruaja ime)”.⁽¹¹⁾

Nëse njëri nga dy sahabët do të thoshte se e kishte parë Pejgamberin s.a.v.s., me një grua në një natë të errët, ai do të thoshte të vërtetën, por të vërtetën e cila nuk është përfundimtare, për shkak se nuk ishin përcaktuar të gjitha rrethanat dhe detajet e ngjarjes, dhe nuk ishte paraqitur fakti se gruaja në fjalë në të vërtetë ishte gruaja e Pejgamberit s.a.v.s., gjë që ndryshon tërësisht gjykimin në lidhje me këtë ndodhi.

Mosngutja në përcjelljen e informacioneve dhe lajmeve

Allahu xh.sh., në suren El-Kalem, fillon me shprehjen:

“Nun. Beto hem në lapsin dhe ato që shkruan ai...”.

Në këtë betim, bëhet paralajmërimi se lapsi dhe ato që shkruan ai, një ditë do të dëshmojnë për njeriun. Njësoj si në ditën kur

⁹ Rreth kësaj shih më shumë në: Ibn Kesir, *Tefsiri i Ibn Kethirit* (botimi i shkurtuar), Zgjedhje versione më të sakta: Muhammed Nesib er-Rifa'i, grupi i përkthyesve, Sarajevë, 2012, f. 1325.

¹⁰ El-Bekare, 111.

¹¹ Buhariu, nr. 3107 dhe Muslimi, nr. 2175.

gjuhët do të heshtin dhe duart, këmbët, lëkura dhe organet e tjera do të dëshmojnë.⁽¹²⁾

I Dërguari i Allahut s.a.v.s., thoshte:

“Është e mjaftueshme për njeriun si gënjeshtër nëse tregon çdo gjë që dëgjon”.⁽¹³⁾

Edhe pasi informacioni të jetë kontrolluar, të jemi njohur me rrethanat dhe të jetë marrë një pasqyrë e plotë rreth tij, nuk duhet të nxitojmë me përhapjen e tij. Asnjëherë informacionet nuk janë përhapur aq shpejt siç është rasti në kohën tonë, kështu që është shumë e rëndësishme që të mbahen në mend paralajmërimet e Pejgamberit s.a.v.s., në lidhje me rreziqet e të folurit dhe të gjuhës. Një paralajmërim i tillë u përcoll nga Ebu Hurejre r.a., duke thënë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s., ka thënë:

“Me të vërtetë njeriu e shqipton një fjalë, duke mos menduar për kuptimin e saj, e për shkak të saj bie në zjarr, më thellë se distanca midis Lindjes dhe Perëndimit”.⁽¹⁴⁾

Në një transmetim tjetër, pak më të gjatë, përmendet se Pejgamberi s.a.v.s., e paralajmëroi Muadh b. Xhebelin r.a., që ta ruajë gjuhën dhe ta “kufizojë” atë, e që Muadhi pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, a do të kërkohet llogari edhe për atë që ne flasim”,

për çka Pejgamberi s.a.v.s., ia ktheu:

“Nëna mos të paq, o Muadh, a do t’i hedh njerëzit me kokë poshtë (në hundët e tyre) në zjarr gjë tjetër përveç të korrat e gjuhës së tyre”!⁽¹⁵⁾

Në këto transmetime të Pejgamberit s.a.v.s., paralajmërohet për rrezikun e të folurit dhe gjuhës, ndërsa në rrjetet sociale kryesisht komunikohet përmes tastierës, në formë shkrimi, pra, me dorë e jo me gjuhë, megjithatë, thelbi është i njëjtë, kështu

¹² Ahmet Tashgetiren, “Çfarë jemi në mediat sociale”?, Etika, Nr. 115 – Tetor 2017, Shqipëri, f. 6.

¹³ Muslimi, nr. 5.

¹⁴ Muslimi, nr. 2290.

¹⁵ Ahmedi, nr. 22016, dhe Tirmidhiu nr. 2616.

që edhe rregulli është identik. Vlen të përmendet se Pejgamberi s.a.v.s., në një hadith tjetër, në të njëjtën kohë paralajmëroi për gjuhën dhe duart:

“Mysliman është ai nga gjuha dhe duart e të cilit janë të qetë myslimanët e tjerë”.⁽¹⁶⁾

Prandaj, para se të ndash ndonjë lajm, verifiko nëse ai është i dobishëm për ta përhapur apo jo. Nëse me të pohohen vlerat pozitive, morali fisnik, inkurajon për të mirë dhe tregon për të keqen, promovon njohuri të dobishme etj., transmetoje atë, por, në qoftë se është e gjithë e kundërta, mos ji pjesëmarrës në përhapjen e tij.

Gjithashtu, në qoftë se bëhet fjalë për prekje në nder të një myslimani apo është në pyetje interesi i përgjithshëm i shoqërisë myslimane, mos i lejo vetes që të marrësh pjesë në përhapjen e tij, sepse, Allahu i lartësuar në Kuran thotë:

“E përse kur e dëgjuan atë (shpifjen) besimtarët dhe besimtarët të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thonë: “Kjo është shpifje e qartë”?! (En-Nur, 12). Dhe thotë: “Madje kur u vjen atyre (mynafikëve) ndonjë lajm qetësues (kur fitojnë myslimanët) ose shqetësues (kur dështojnë), ata e përhapin atë...”

(En-Nisa', 83).

Komentuesi i Kuranit, Abdurrahman es-Sadiu, duke e komentuar këtë ajet thotë:

“Në këtë ajet, gjithashtu, dënohet dhe ndalohet nxitimi në përhapjen e lajmit, menjëherë pas dëgjimit të tij, dhe është urdhëruar që të mendohet para se të flitet, dhe të merret në konsideratë se a ka dobi që njeriu të merret me këtë, ose është në dështim marrja me të në mënyrë që të abstenohet nga kjo”.⁽¹⁷⁾

Paraqitja e qëndrimit dhe e mendimit personal duke mos i lënduar njerëzit e tjerë

Qëndrimi dhe mendimi në lidhje me dikë apo diçka krijohet përmes përvojës personale të lidhur me marrjen e informacioneve

¹⁶ Buhariu, nr. 10, dhe Muslimi, nr. 41.

¹⁷ Abdurrahman es-Sadiu, *Tejsirul Kerimir-Rahman fi Tefsiri Kelamul-Menar*, Daru Ibni-Xhevzi, Arabia Saudite, 1422 H., f. 330.

për objektin/ subjektin rreth të cilit është marrë qëndrimi. Njerëzit shpirtërisht të paqëndrueshëm, pikëpamjet dhe pakënaqësitë e tyre me dikë apo diçka në përgjithësi kërkojnë t'i demonstrojnë në mungesën e personit të caktuar, por disa edhe në praninë e personit në fjalë, me bindjen se vetëm mendimi i tyre është i saktë. Shpesh në situata të tilla ndërhyjnë pa pasur prova dhe argumente të mjaftueshme e të vlefshme, e që është rezultat i paaftësisë për të patur një qëndrim të qartë për njerëz të caktuar apo për t'i parë fenomenet ashtu siç duhet. Ndërhyrja dhe paraqitja e qëndrimeve dhe e mendimeve në dritën e urtësisë kuranore manifestohet përmes aftësisë për të vlerësuar gjendjen reale me argumentim të vlefshëm, i cili, ndër të tjera, fitohet duke kontrolluar informacione në lidhje me objektin/ subjektin e vlerësimit. Në lidhje me këtë do të përmendim udhëzimin kuranor se si të veprohet gjatë marrjes së informacionit. Allahu thotë:

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë”.⁽¹⁸⁾

Folja فَتَنَّاوَا - “të shqyrtohet”, “të kontrollohet”, në disa kiraete mund të lexohet edhe فَتَنَّاوَا - “jini të përmbajtur”. Leximi në këtë version i kësaj foljeje në formën فَتَنَّاوَا shpreh kuptimin e foljes فَتَنَّاوَا, për shkak se për të ardhur deri tek informacionet reale gjatë kontrollimit të informacioneve është e nevojshme koha dhe analiza e kujdesshme.⁽¹⁹⁾

Bazuar në ajetin e mësipërm shohim se është detyrim i rreptë për myslimanin (farz) që të kontrollojë mirë informacionet që i vijnë në çfarëdo mënyre, e që njëherazi është edhe parimi kryesor gjatë marrjes së qëndrimit dhe formimit të opinionëve. Pas kësaj, pa dyshim që do të jemi në gjendje të shprehim mendimin tonë, të konsultojmë tjetrin, madje edhe të bëjmë kritikë konstruktive. Personi që i nënshtrohet kritikës konstruktive apo këshillës, në qoftë se është shpirtërisht i pjekur dhe i vetëdijshëm për mundësitë dhe kufizimet e tij, nuk do të ndjejë shqetësim në lidhje me fjalët tona, për më tepër, do të na jetë mirënjohës. Prandaj, marrëdhëniet

¹⁸ El-Huxhurat, 6.

¹⁹ Shih: Hfz. Dževad Šošić, *Kiraeti u tefsiru El-Čāmi’ li aḥkāmi-l-Qur’ān imama Kurtubija*, FIN dhe El-Kalem, Sarajevë, 2014, f. 192.

me njerëzit e tjerë në masë të madhe varen nga shkalla jonë e vet-edukimit në drejtim të dhënies dhe marrjes së kritikave apo këshillave, paraqitjen e qëndrimeve dhe mendimeve personale apo dëgjimit prej njerëzve tjerë.

Fol vetëm të bukurën, të mirën!

Të jesh mysliman dhe të quash veten mysliman është një nder i madh, por njëkohësisht edhe përgjegjësi e madhe. Ne do të vërejmë se njerëzit rreth këtyre mirësive, por edhe përgjegjësive nuk janë plotësisht të vetëdijshëm. Ata që janë të vetëdijshëm dallohen në shumë karakteristika.. Kjo vihet re në shtëpitë e tyre, në punë, në rrugë, në xhami dhe kudo.

Fjalimi i bukur është urdhëruar në mënyrë eksplicite për çdo mysliman dhe kjo urdhëresë është e regjistruar në Kuran dhe në Synet. Në Kuranin madhështor, Allahu xh.sh., thotë:

“A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: – fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart, e që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë”

(Ibrahim, 24-25)

Po ashtu, Allahu i plotfuqishëm i urdhëron robërit e tij:

“E ti robëro e të mi thua ju: “Le ta thonë atë që është më e mira, pse djalli ndërson mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut””

(El-Isra’, 53)

Në një nga hadithet e Muhamedit s.a.v.s., thuhet:

“Kush beson në Allahun xh.sh., dhe botën tjetër, le të flasë të vërtetën ose le të heshtë”

(Buhariu)

Po ashtu, në një hadith tjetër thuhet:

“Kur të përshëndetni dikë, është mirësi. Kur të veproni drejt, është mirësi. Fjala e mirë është mirësi”

(Buhariu dhe Muslimi)

Kur duam të postojmë ndonjë status, të dërgojmë porosi në ndonjë grup, ose të japim ndonjë koment etj., duhet të kemi ndër mend këtë ajet kuranor para se ta dërgojmë atë, të mendojmë nëse teksti ynë është i bukur. Të mendohemi se ndoshta me tekstin tonë do ta fyejmë dikë, apo ndoshta prekim dikë në ndjenjat e tij. Pra, nëse teksti përbën një nga këto elemente, duhet ta kemi të qartë se ai nuk është i bukur, dhe se është mirë që të mos e shpallim atë, apo ta fshijmë sa më shpejt që është e mundur. Mirëpo, nëse kërkon për fjalimin më të bukur, sigurisht se do ta gjesh atë në Kuranin fisnik:

“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut...”

(Fusilet, 33)

Fëmijët dhe përdorimi i internetit

Tema “Fëmijët dhe përdorimi i internetit/rrjetit social” është shumë aktuale në mesin e prindërve, psikologëve, pedagogëve dhe teologëve.

Fëmijët në mbarë botën janë duke u bërë përdorues të profileve në rrjetet e ndryshme sociale, duke hapur profile në rrjetet sociale facebook, twitter etj., duke paraqitur moshën e tyre në mënyrë të rrejshme. Mirëpo, parashtrohet pyetja se çfarë është në të vërtetë ndikimi i internetit dhe i teknologjisë së përparuar për fëmijët dhe se sa është ai i modifikuar dhe i keqpërdorur.

Fëmijët që nga mosha 7 – 11-vjeçare janë kryesisht të njohur me funksionimin e kompjuterave, telefonave celularë me opsione të fundit, tableta, pajisjet e Apple-it. Që atëherë, fillojnë me përdorimin e rrjeteve sociale dhe i lëshohen botës virtuale. Ekzistojnë vetëm ata dhe kompjuteri. Orë të tëra i përkushtojnë internetit. Vendosin fotot, shkëmbejnë informacione private me të tjerët, shkruajnë me njëri-tjetrin, komentojnë dhe kështu bëhen objektiv i lehtë, i shkatërrimit, qoftë në aspektin sociologjik ashtu edhe psikologjik.

Disa nga ndikimet fillestare negative janë sigurisht izolimi social dhe largimi nga librat, largimi nga shoqëria dhe kalimit të kohës në mënyrë jocilësore. Mund të jenë të ekspozuar ndaj mesazheve armiqësore apo shqetësuese. Fëmijët të cilët përdorin

internetin mund të bëhen objektiv i trukeve reklamuese dhe viruseve kompjuterike. Interneti është bërë një fushë globale në të cilën pedofilia ka gjetur vendin e saj dhe atë nëpërmjet chatit, bisedës me video dhe kërkesave të miqësisë. Shpesh të tillët fshihen pas profileve të rrejshme, fotografive të fëmijëve ose statuseve “të miqve të prindërve”.

Gjithashtu, ajo që është sigurisht rezultat i rritjes së përdorimit të jashtëzakonshëm të internetit, është edhe prapambetja mendore. Fëmijët janë të ndarë, më pak mësojnë, nuk kanë kohë për lexim, filma vizatimorë dhe programe edukativo-arsimore, nuk shoqërohen, nuk dalin përjashta për argëtim dhe lojë.

Ajo që është më e rëndësishme është kontrolli prindëror ose lidhja fëmijë-prind-internet. Vetëm drejtimi i duhur, angazhimi dhe bashkëpunimi mund ta shpëtojë fëmijën prej ndikimeve negative dhe t’i mundësojë qasjen e dobishme dhe të shëndetshme në internet.⁽²⁰⁾

Nuk ka asnjë dyshim se edukimi i fëmijëve apo edukimi i brezave të rinj është një përgjegjësi e madhe dhe barrë që duhet kryer bashkërisht, veçanërisht prindërit dhe të gjitha institucionet shoqërore, detyra e të cilëve është që t’i edukojnë fëmijët dhe të rinjtë.⁽²¹⁾

Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...”⁽²²⁾

Familjet tona dhe shpirti ynë na janë dhënë në amanet. Në Ditën Gjykimit do të kemi përgjegjësi për veprat tona dhe për fëmijët tanë. Muhamedi s.a.v.s., këtë na e bën me dije me një hadith ku thotë:

“Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë do të përgjigjeni për tufën tuaj...”

(Muttefekun alejhi)⁽²³⁾

²⁰<http://www.kolektiv.me/21601/Internet-kaodjecija-manija-problem-savremenog-drustva>, qasja në internet, me datën: 01.03.2018.

²¹ Abdullah Nasih Ulvan, *Odgoj djece u islamu*, Përktheu: Mustafa Jahić, botues: Aktivna islamska omladina, Sarajevë, 2003, f. 5.

²² Surja Tahrim, 6.

²³ Jahja ibn Sharaf An-Nawawi, *Rijadu-Salihin*, përktheu: Fuad Sedić dhe të

Pavarësisht prej asaj që kemi përmendur, për fat të keq, mund të shohim se një numër i madh i prindërve nuk ka fare ide se ku gjenden fëmijët e tyre, me çfarë shoqërie janë duke u shoqëruar dhe çfarë vendesh vizitojnë ata, dhe si i përdorin internetin, smartfonat etj. Këta prindër kanë lënë pas dore plotësisht edukimin e fëmijëve të tyre dhe nuk interesohen fare për zhvillimin dhe rezultatet e fëmijëve, e as që ju japin atyre këshillat e duhura dhe udhëzime në momentet kur janë më të nevojshme përta. Megjithatë, kur më pas këta prindër ballafaqohen me vrazhdësi dhe mosbindje nga fëmijët, fillojnë me vajtimet dhe ankesat, kurse dëshpërimin e tyre e paraqesin para të gjithëve dhe në çdo vend. Për fat të keq, as që janë të vetëdijshëm se ata janë arsyeja kryesore e një gjendjeje të tillë të fëmijëve të tyre. ⁽²⁴⁾

Konkluzione:

Koha në të cilën jetojmë, e quajtur si kohë moderne apo kohë e teknologjisë së zhvilluar, njeriut i mundëson dhe i lehtëson shumë gjëra, mirëpo, në të njëjtën kohë ajo paraqet edhe sfida për njeriun bashkëkohor;

Njeriu në saje të teknologjisë dhe internetit, sot dëshiron të arrijë gjithçka, të dijë gjithçka dhe të shfrytëzojë internetin dhe teknologjinë e përparuar, duke mos menduar për pasojat negative që do të reflektohen tek ai, familja e tij dhe shoqëria në përgjithësi;

Çdo gjë e ka prapavijën e vet dhe është në shërbim të njeriut, ashtu edhe interneti. Varësisht se si e përdor atë, do të reflektohet në të mirën apo në të keqen e tij, e gjitha si pasojë e përdorimit apo keqpërdorimit të tij, kështu që, njeriu ose do ta shfrytëzojë internetin ose atë do ta shfrytëzojë interneti;

Njeriu sot, duke shikuar në përgjithësi, humb shumë kohë duke qëndruar para ekranit të kompjuterit, e në anën tjetër i lë anash obligimet fetare, familjare e shoqërore, e që pas gjithë kësaj pason përgjegjësia dhe problemi;

tjerët., botues: Komiteti i lartë saudit për ndihmë në BeH dhe Qendra kulturore "Mbreti Fahd" në Sarajevë, Sarajevë, 1998, f. 77.

²⁴ Šejh Muhammed b. Ibrahim el-Hamd, *Opasne greške u odgoju djece*, El-Kelimeh, Novi Pazar, 2003, f. 11.

Sot njeriu mund të dëgjojë një informacion a lajm i cili përhapet për një kohë shumë të shkurtër e me të madhe, dhe këtë shpesh e përhapin njerëzit pa e kontrolluar dhe pa e vërtetuar saktësinë e tij, e si pasojë dalin në pah fërkime të natyrave të ndryshme, për çka besimtari dhe besimtarja duhet të kenë shumë kujdes;

Interneti dhe rrjetet sociale, janë shkaktarë të prishjes së moralit te të rinjtë tanë, humbin kohë tej mase, largohen nga libri dhe mësimet, nuk shoqërohen, luajnë lojëra të cilat reflektohen në përditshmërinë e tyre në arrogancë, nervozizëm e konflikte të ndryshme ndërfamiljare.

Dhe së fundmi, është e rëndësishme të theksohet se myslimani është i detyruar të ruhet nga e keqja që mbart interneti, por nga ana tjetër është i detyruar që të përpiqet edhe të përfitojë nga potencialet dhe mundësitë që ofron ky mjet modern i informimit. Është e vërtetë se mbrojtja nga e keqja është një sukses i madh, por kjo nuk mund të jetë qëllimi i vetëm i yni. Është një dëm i madh që të mos shfrytëzohen mundësitë që ofron ky mjet në të gjitha aspektet, veçanërisht në fushën e predikimit të islamit, edukimit, përkujtimeve, udhëzimeve dhe gjithçka tjetër që na afron me Allahun e plotfuqishëm.